



PROMOVIMI I KULTURËS, TRADITËS DHE GJUHËS SË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

HISTORI SUKSESI E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

Titulli i botimit

Histori suksemi e romëve dhe egjiptianëve

Botuesi

Građanska alijansa – Civic Alliance – Aleanca Qytetare

Për botuesin

Millan Radoviq

Redaktorë

Zoran Vujiçiq, Jellena Ristoviq dhe Amina Muriq

Përpunimi teknik dhe dizajni

Mastermind P&M

Shtypi

AP print

Tirazhi

150 kopje

Vendi dhe viti i botimit

Podgoricë, qershor 2022

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе,
Цетиње

ISBN 978-9940-741-20-4
COBISS.CG-ID 22541316



MINISTARSTVO LJUDSKIH I MANJINSKIH PRAVA

**Projekti është mbështetur
nga Ministria e të Drejtave
të Njeriut dhe të Pakicave**

I Përmbajtja

II Informacionet e mëparshme

III Histori suksemi e romëve dhe egjiptianëve

Irijana Rizvanoviq	6
Jasmina Berisha	8
Sokol Beganaj	10
Zoja Tarllamishaj	14
Elvis Berisha	16
Shejlla Pepiq	19
Milaim Delia	22
Linda Jefkaj	24
Sabina, Monika dhe Leontina Ramadanoviq	26
Anita Berisha	27

II Informacionet e mëparshme

Të dashur/a lexues dhe lexuese,

Para jush është botimi “Histori suksesi e romëve dhe egjiptianëve” i cili është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i kulturës, traditës dhe gjuhës së romëve dhe egjiptianëve”, mbështetur nga Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave. Publikimi përmban 10 histori të romëve dhe egjiptianëve të suksesshëm në fushën shoqëro-politike dhe sektorin civil. Projekti “Promovimi i kulturës, traditës dhe gjuhës së romëve dhe egjiptianëve” ka për qëllim të kontribuojë në zvogëlimin e distancës etnike dhe diskriminimit ndaj romëve dhe egjiptianëve në Mal të Zi. Ne jemi të bindur se përmes pasqyrimin të historive konkrete të suksesit të individëve nga ky komunitet kontribuojmë në arritjen e këtij qëllimi, sepse qytetarët duke lexuar këto tregime njihen me kulturën, traditën dhe gjuhën e romëve dhe egjiptianëve, por edhe me sfidat, sakrificat dhe pengesat e tyre që është dashur t’i kapërcejnë për të arritur atje ku janë sot. Me këtë, suksesi i tyre është edhe më i rëndësishëm, sepse krahas vështirësive financiare, stigmatizimit dhe diskriminimit të mjedisit ata krahas kësaj kanë arritur rezultate të tilla. Ne jemi të bindur se aktivitetet e ngjashme mund të kontribuojnë ndjeshëm në njohjen reciproke dhe pranimin e diversitetit, që është parakusht i domosdoshëm për kohezionin social dhe shoqërinë qytetare pa diskriminim dhe distancë etnike. Në fund, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata që pranuan të tregojnë historitë e tyre dhe që kuptuan se në këtë mënyrë ata mund të ndihmojnë komunitetin e tyre në përpjekje për mundësi dhe kushte të barabarta që kanë edhe të tjerët në Mal të Zi.

Me nderime,

Zoran Vujićiq, koordinator i projektit

III Historitë e suksesit të romëve dhe egjiptianëve



Emri im është Rizvanović Irijana. Irijana është emër me origjinë të përzier. Ai përbëhet nga gjermanishtja Irena dhe greqishtja Helena - të dy emrat kanë një kuptim të ngjashëm “paqe”. Pseudonimi im është Riri dhe shumica më thërrasin kështu.

Aktualisht jam studente në Fakultetin Filologjik në Nikshiq. Në vitin e dytë të studimeve universitare studioj gjuhë dhe letërsi angleze. Studimet e mia po shkojnë relativisht mirë. I dua gjuhët dhe kjo mund të vërehet, sepse tashmë flas rrjedhshëm katër gjuhë (rome, malazeze, gjermane dhe angleze) dhe do të doja të mësoja më shumë. Jam e para rome nga veriu i Malit të Zi (Bijello Polë) që regjistrohem në fakultet dhe jam e para që kam mbaruar shkollën fillore dhe të mesme, si dhe kopshtin, me rezultate mjaft të mira.

Unë kam lindur, më 16 tetor 1998 në Hamburg-Wandsbek, Gjermani, ku jetova deri në moshën tre vjeçare. Për arsye shëndetësore, frekuentova kopshtin vetëm nga mosha shtatë vjeçare; ishte ky kopshti Dusho Basekiq “Pçellica” në Bijello Polë. Unë në atë kohë nuk flisja gjuhën malazeze, por ishte një mësuese (Sonja Peković) që më kushtoi vëmendje dhe ngjalli vullnetin tim për të vazhduar mësimin, kështu që mësova gjithnjë e më shumë si një bletë e zellshme. Më pas kam ndjekur Shkollën fillore “Dushan Koraq” nga viti 2006 deri në vitin 2011, ku jam pranuar nga stafi mësimdhënës, e pak a shumë edhe nga nxënësit. Kishte provokime dhe dhunë nga bashkëmoshatarët, sepse isha “ndryshe”; megjithatë, mësuesit nuk lejuan që kjo të vazhdojë. Mësuesja Peković ishte si një nënë e dytë për mua. Më vonë, për shkak të ndërrimit të vendbanimit, më është dashur të ndërroj shkollën, kështu që nga viti 2012 deri në vitin 2014 kam ndjekur Shkollën fillore “Pavle Zhizhiq” – në Njegnjevë. Këtu pësoi rënje suksesi dhe motivimi im, sepse nuk njihja askënd dhe binte në sy se nuk më pranuan si në shkollën “Dushan Koraq”. Madje, mësuesit dhe profesorët më thërrisnin me emra të tjerë në vend të emrave të mi (këto ishin emrat e nxënësve romë të moshuar që e kishin braktisur shkollën fillore dekada para se të regjistrohesha atje), për të mos përmendur dhunën e bashkëmoshatarëve që përjetova atje. Megjithatë, kjo nuk më pengoi të vazhdoja shkollimin.

Nga viti 2015 deri në vitin 2017 u ktheva në Gjermani, ku vazhdova klasën e nëntë (Diet-

rich-Bonhoeffer-Schule në Bargteheide) dhe klasën e parë të shkollës së mesme (Berufliche Schule des Kreises Stormarn në Bad Oldesloe), ku u kthehe motivimi sepse u pranua sërisht, si një person normal. Fusha që studiova quhej Fachrichtung Technik, teknologji lëndore. Më në fund u ktheva në Mal të Zi, ku doja të mbaroja shkollën e mesme. Mirëpo, dëftesat e mia nga Gjermania nuk i njihnin, ndaj më duhej të përsërisja mësimet, duke humbur 2 vite arsim, si dhe brezin tim. Pasi përsërita vitet, vetëm atëherë munda të vazhdoja shkollën e mesme. U regjistrova në Shkollën e Mesme të Inxhinierisë Elektrike në Bijello Polë, në drejtimin Administrator/e. Por duke qenë se, thënë më butë, më vinte keq që më duhej të humb padrejtësisht vitet e mia të shkollimit dhe për këtë jam ankuar në Ministrinë e Arsimit dhe në Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave që të më jepnin mundësinë për të ndjekur dy shkolla të mesme në të njëjtën kohë. Gjë që më në fund mu bë e mundur. Në të njëjtën kohë mbarova kursin e teknikut të turizmit (kursin katër-vjeçar) në Shkollën e mesme profesionale në Bijello Polë, ku pata rezultate mjaft të mira dhe si Administrator/e isha nxënëse e shkëlqyeshme gjatë 3 viteve (drejtimi tre-vjeçar). Nga viti 2020 e deri më tani vijoj Fakultetin Filologjik në Nikshiq, ku studioj gjuhë dhe letërsi angleze. Studimet po më ecin relativisht mirë dhe jam shumë e kënaqur. Shpresoj të vazhdoj shkollimin, siç kam bërë deri tani. Unë përpiqem të jem njeriu i vetes, e pavarur dhe e arsimuar. Ky është qëllimi im i vërtetë dhe objektivat që i kam vënë para vetes deri më tani janë përmbushur me sukses. Përveç studimeve më pëlqen të shkruaj edhe poezi. Është një nga hobet e mia që më relakson. Megjithatë, nuk do të doja ta bëja këtë në publik. Pra, është një hobi që do të doja ta mbaja për vete. Përveç kësaj, më pëlqen të mësoj gjuhë të huaja. Gjuhët që do të doja të mësoja janë spanjisht, italisht dhe japonisht. Por tani për tani, më duhet të fokusohem te universiteti dhe pas kësaj do të shoh se ku do të më çojë jeta.



Unë jam Jasmina Berisha, nxënëse në Shkollën e Mesme Ekonomike “Mirko Veshoviç”. Unë vijoj klasën e parë në drejtimin Juridiko-Administrativ. Kam mbaruar Shkollën fillore “Bozhidar Vukoviç Podgoriçanin” dhe jam një rome e rrallë që kam fituar diplomën “Pishtar”. Nuk ka asnjë fjalë, më duket, që mund të përshkruajë atë që bëj, sepse kam gjetur veten në fusha të ndryshme. Ajo me çka më së shumti merrem janë të drejtat dhe liritë e njeriut. Kam pesë vite që jam aktiviste dhe kam filluar që në moshën dhjetë vjeçare. Unë jam një Këshilltare e Artë e Mbrojtjes së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, anëtare e ekipit të kopshtit i cili ka disa anëtarë të rinj që zbatojnë idetë/iniciativat e tyre me mbështetjen e BE-së. Unë jam gjithashtu anëtare e disa OJQ-ve, si OJQ Phiren Amenca – Eçni me ne, OJQ Sistem, OJQ Cellulla. Fusha në të cilën e gjej veten është gazetaria. Lidhur me këtë, bashkë me një shoqe, tashmë kolegen Selma Drini, po drejtoj një podcast në portalin RomaNet të quajtur “Ternengo Avazi” - Zëri i Rinisë.

Historia ime e jetës është krejtësisht e paplanifikuar, e papritur. Nëse dikush do të më pyeste si fëmijë nëse doja të bëhesha gazetarë apo të kisha zyrën time, do të thosha jo, sepse si fëmijë doja të bëhesha astronute apo mjeke, ndërsa tani nuk e gjej veten fare në këto profesione.

Nëpërmjet edukimit tim gjithmonë hasi në pengesa, ofendime e gjëra të ngjashme. Në fillim e kam pasur shumë të vështirë ta përballoj dhe tani për fat të keq më është bërë e përditshme dhe më ndodh që shumë shpesh, thjesht i shpërfilli të gjitha ofendimet.

Krahas të gjitha ofendimeve, gjithsesi arrita të tregoja veten dhe komunitetin rom në mënyrën më të mirë. Pra, kur isha ende në shkollën fillore, kisha një mbështetje të madhe nga mësuesit dhe drejtorja e shkollës për arsimimin tim. Kam pasur fatin që kam pasur një mësuese si Dragica Vukçeviç, Jasmina Lliçina etj. Kushdo që ka pasur rastin t'i dëgjojë një herë ligjëratat e tyre, do ta dijë se për çfarë po flas. Kjo është mbështetja që më duhej jashtë shkollës. Falë Dragica Vukçeviç që më inkurajoi të studioj dhe t'i përkushtohem aktiviteteve jashtëshkollore dhe të dobishme, jam gruaja e parë rome që merr çmimin “Shkëlqyeshëm 5!” me të cilin Ministria e Arsimit i shpërblen çdo vit, nxënësit dhe mësuesit më aktivë dhe

më të suksesshëm. Duke folur për këtë çmim, mund të përmend edhe Çmimin Botëror të Paqes për Fëmijë. Unë u nominova për këtë çmim nga Institucioni i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive, nga 163 fëmijë nga e gjithë bota, hyra në rrethin e 30 prej tyre. Ky është një sukses i madh për mua. Unë thashë në fillim se jeta ime ishte e papritur; kam një të metë, dhe ajo është se gjithmonë gjej të meta tek vetja. Unë gjej gjithmonë diçka që nuk është e mirë dhe sipas rrethit tim nuk është kështu, por e kundërta. Kështu, p.sh., thashë me vete se nuk isha e pjekur sa duhet për këto çmime, por ishte krejtësisht ndryshe. Jetojmë në një botë ku komuniteti rom prezantohet vetëm si “ndërtesat në Vrella” dhe kjo më frymëzoi të krijoja një podcast me mikun tim “Ternengo Avazi”, ku do të ndryshonim imazhin e komunitetit shumicë për komunitetin rom.

Gjatë këtyre pak viteve të shkollimit, dhe kam ende edhe shumë të tjera, ka pasur momente kur kam hequr dorë nga shoqërimi me miqtë, të shkoj në kinema, kam kaluar pak kohë me familjen time sepse dita ime e punës ka zgjatur nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 17 dhe më shumë, kështu që kam pasur pak kohë për obligimet e mia private. Por mendoj se gjithçka shpërblehet dhe se, me kalimin e kohës, do të ketë edhe më shumë.

Dua të dërgoj vetëm një mesazh inkurajues për të gjithë bashkëmoshatarët e mi. Nuk ka rëndësi nëse je malazez, rom apo shqiptar, mos lejoni që fjalët e të tjerëve të ju frenojnë, përkushtohuni vetes, punoni me veten tuaj, ndërtoni UNIN tuaj!

Vendosni vetes një qëllim dhe punoni në realizimin e tij, pavarësisht se sa e gjatë është rruga, do të ja arrini qëllimit tuaj!

Sokol Beganaj

Shef i Departamentit për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Ministrinë e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.



Shef i Departamentit për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Ministrinë e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave.

Në Departamentin për Përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Ministrinë e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave kryhen detyra që lidhen me: çështjet e përgjithshme të pozitës së romëve dhe egjiptianëve; kryerjen e aktiviteteve në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të romëve dhe egjiptianëve në lidhje me aderimin dhe anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian; ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme administrative për të përmbushur të drejtat e romëve dhe egjiptianëve që rrjedhin nga anëtarësimi në Këshillin e Evropës dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara; monitorimin dhe realizimin e të drejtave kulturore, arsimore, gjuhësore, fetare dhe të tjera që lidhen me avancimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve; përgatitjen dhe zbatimin e dokumenteve strategjike në lidhje me përmirësimin e pozitës së romëve dhe egjiptianëve; kryerjen e detyrave të tjera me rëndësi për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve dhe përfshirjen e tyre në shoqërinë malazeze, si dhe punë të tjera përkatëse në kuadër të kësaj Ministrie. Unë jam i punësuar në këtë Ministri që nga viti 2010 (Ministria e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave).

Në kohën e lirë më pëlqen të shkruaj poezi, libra apo skenarë për shfaqje teatrale. Kam shkruar një përmbledhje me poezi me titull: “Këngë për romët” Podgoricë - 2012, në gjuhën rome dhe malazeze; Autobiografia “Edukimi i një romi nga varfëria në ministri”; Tema e magjistraturës “Qasjet kundër diskriminimit në sistemin parashkollor të Malit të Zi” – 2016; “Ruarjtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar - promovimi i historisë, kulturës, gjuhës dhe veçorive të tjera të identitetit kombëtar të popullatës rome dhe egjiptiane duke hulumtuar dhe botuar një botim për pjesëtarët e popullatës rome dhe egjiptiane në komunën e Nikshiqit” – 2016; “Për luftën kundër martesave të hershme me shkuesi dhe rëndësinë e arsimit të romëve” – 2021; Shfaqjet teatrale që kam drejtuar, shkruar dhe aktruar: “Mjeshtër fshesa”, “Ditari im”, “Dasma rome”, shfaqjet teatrale për fëmijë: “Kam shumë nevojë për ty”, “Dua të jem fëmijë”, “Livadhi”, “Doktoresh Masha “,

“ Miqësia “,” Personazhet e Përrallave “,” Viti i Ri “,” Në shkollën Niks”.

Unë kam lindur si fëmija i katërt, prej tetë fëmijësh dhe në një familje të varfër rome. Të pestë vëllezërit, tri motrat, babai dhe nëna jetonim në një barakë të rrënuar në Nikshiq, e cila kishte dy dhoma të vogla me përmasa tre me tre metra. Kur shkoni në shtrat, dukeshin si sardelet kur të rreshtohen, sepse nuk kishte vend të mjaftueshëm për të gjithë. Kjo ishte normale, sepse edhe romë të tjerë jetonin në atë vendbanim ku jetonim ne. Kur i mbusha shtatë vjeç, më mori motra e madhe dhe më regjistroi në Shkollën fillore “Luka Simonoviq”, e cila ndodhej afër stadiumit të vogël në Nikshiq. Në fillim nuk i dija as fjalët e gjuhës serbo-kroate që ishte në përdorim zyrtar në atë kohë. Kjo është arsyeja pse u ula në bankën e fundit dhe dëgjoja miqtë e mi që flisnin dhe përgjigjeshin, ndërsa unë thjesht heshtja. Vitet e para ishin më të vështira për mua, sepse duhej të zotëroja gjuhën për të qenë aktiv në shkollë. Babai im i ndërë punonte në Ndërmarrjen Komunale dhe gjithmonë përpiquej të na motivonte për të mësuar. Ai na tha: “Nëse nuk e mbaroni shkollën, do të vuani gjithmonë, do të jeni gjithmonë të varfër dhe përfundimisht do të punoni në Komunale”.

Sa e varfër ishte familja jonë ilustruhet nga anekdota ime e mëposhtme. Një ditë kur mësuësja e edukatës fizike na tha se të gjithë fëmijët duhet të kenë pajisje speciale në çantën e tyre, e cila është: pantallona të shkurtra blu, atlete, çorape të bardha dhe një kanatiere të bardhë. Unë disi gjeta një kanatiere të bardhë, pantallonat e shkurtra blu me të cilat luaja futboll në atë kohë, kisha atlete që i vishja çdo ditë, por i laja dhe i rregulloja pak, por më mungonin çorapet e bardha që nuk i kisha. E pyeta mamanë nëse mund të më blejë dhe ajo m’u përgjigj: “Bir ne jemi të varfër, nuk kemi”. Pastaj fillova të qaja, të qaja dhe nuk u ndala. Qava aq shumë sa nuk munda. Nuk mund të qetësohesha përderisa nëna ime në një moment më tha: “Fli dhe kur të zgjohesh do t’i kesh çorapet”. Unë i besova asaj sepse ajo kurrë nuk më gënjeu. Pastaj u kujtua nëna ime, ajo preu getat e bardha të motrës sime dhe më bëri çorape. Lumturia ime nuk kishte fund. Nuk ishte më mirë as me rroba, kështu që prisja të vinte vëllai nga shkolla dhe të vishja rrobat. Pavarësisht gjithë kësaj, ne kurrë nuk kërkonim lëmshë. Kemi ngrënë tre vakte, dhe kur ka ndodhur që nuk ka pasur asnjë - kemi heshtur. Këto janë disa nga kujtimet e mia nga shkolla fillore.

Kur u regjistrova në shkollën e mesme ishte aktual arsimi i orientuar. U regjistrova në drejtimin e Minierave dhe atë vit ndodhi një aksident në minierë dhe babai më tha të lija shkollën, kështu që bëra një pushim dhe vitin e ardhshëm u regjistrova në drejtimin e Teknikut të Trafikut. Në fillim të vitit shkollor na u desh të prezantoheshim me profesorët e rinj dhe të gjithë individualisht ta informonin se çfarë nxënësish jemi. Kur më erdhi radha, thashë që isha përsëritës, se përsërita vitin, pasi kisha lënë drejtimin për minator dhe se u regjistrova në drejtimin për teknik trafiku. Një profesor që më mësonte dy lëndë profesionale, pa që kisha mjaft sukses në dy vitet e para të gjimnazit dhe më tha: “Sokol, je i shëndoshë dhe i ri, pse nuk bën diçka për të ndihmuar familjen? Gjithsesi do të humbasësh kohën në shkollë dhe kjo nuk është e mirë as për ty dhe as për familjen tënde”. Në atë moment më shpërtheu diçka, ngrita kokën dhe thashë: Dëgjo profesor! Unë do t’ju tregoj se edhe një rom mund të

mbarojë shkollën e mesme. Ai qeshi me këtë dhe tha: “Do të doja që të mundesh, por ti i di mundësitë e tua. Nuk njoh një rom që ka mbaruar shkollën e mesme.” Megjithatë, i thashë se do ta mbaroja – i premtova diçka që as vet nuk e besoja.

Pas kësaj, i vendosa vetes synimin që të mësoja të gjitha mësimet dhe të angazhohesha në mësim. Taktika ime ishte të paraqitem për t’u përgjigjur përpara se profesorët të na thërrisnin me emra. Më kujtohet, u lajmërova për herë të parë nga gjeografia. Profeshori u mahnit kur pa dorën time dhe kjo ishte nota e parë katër në shkollimin tim. Isha i kënaqur, por në të njëjtën kohë isha shumë i frikësuar dhe pyetesha se çfarë të bëja më pas. Ishte e nevojshme të justifikoja notën katër dhe të marr notat e tjera. Kam mësuar vazhdimisht, në kushte ku nuk kishim as tavolinë dhe as kushtet elementare për të mësuar. Filluan të rreshtoheshin notat katër dhe pesë. Erdhi dita që të përgjigjem para atij profesori dhe mora pesë nga të dyja lëndët. Vazhdova të mësoja dhe nga nxënësi më i dobët u bëra ndër më të mirët. Tani u lavdërova, më i miri! Gjithmonë dija gjithçka, miqtë e mi më donin, u pëshpëritja, i ndihmoja të mësonin. Ne ndërtaam një marrëdhënie më të ngushtë. Më vonë u zgjodha kryetar i rinisë në shkollën e mesme dhe profesorët e mi më anëtarësuan në Partinë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ), që ishte një nder i veçantë për mua. Unë mbarova shkollën e mesme si nxënësi më i mirë në klasë dhe profesori që më këshilloi të braktisja shkollën më nxori para dërrasës dhe më tha: “Sokol, ti je shembulli më i mirë në punën time deri tani dhe do ta them gjithmonë. Gjeneratat e tjera - po që kushdo që dëshiron të jetë i suksesshëm mund ta bëjë atë”.

Pasi mbarova shkollën e mesme u martova dhe fitova një vajzë dhe një djalë. Në atë kohë, pas mbarimit të shkollës së mesme, mendoja se isha romi më i arsimuar, se kisha arritur shumë në jetë, se arsimimi im ishte i paarritshëm. Para meje vetëm një rom kishte mbaruar shkollën e mesme. Pastaj erdha në vete dhe kuptova se shkolla e mesme nuk kishte aq rëndësi për mua sa e kisha imagjinuar. Nuk arrita të punësohem në këtë profesion, kështu që fillova të punoj në Ndërmarrjen Publike Komunale dhe të pastroj rrugët e Nikshiqit, sepse duhej të kujdesesha për familjen time. Më lëndoi kur kolegët e mi më thanë: “Ti ke shkollën e mesme dhe ne nuk kemi mbaruar asgjë nga shkolla dhe siç e sheh ne po bëjmë të njëjtën punë, thjesht ke humbur kohën tënde në atë shkollë”. Nuk mund të përgjigjesha asgjë, thjesht heshtja. Gjatë luftës, nga viti 1992 deri në vitin 1997 kam shkuar jashtë shtetit me familjen time në Gjermani për të shpëtuar nga lufta. Në Gjermani kam punuar në McDonald’s dhe kam njohur një jetë ndryshe. Kishim gjithçka, ushqim, rroba, fëmijët shkonin në shkollë. Më në fund isha i shkujdesur dhe më pas më thanë se prindërit e mi ishin të sëmurë. U kthyem dhe u përballa sërish me varfërinë. Isha sërish pa punë dhe sërish pasoi lufta për mbijetesë. Disi kam arritur të marr ndihmë sociale prej 80 markash, që në atë kohë nuk më mjaftonin sa për të ushqyer familjen. Arrita të punësohem sërish në Ndërmarrjen Publike Komunale në Nikshiq. Në atë kohë, OSBE-ja nisi një projekt që maturantët romë të vazhdojnë shkollimin. Pastaj aplikova dhe zgjodha Fakultetin Filozofik, Departamenti i Edukimit Parashtetor. Pesë romë, mes tyre edhe unë, hynë për herë të parë në Fakultetin Filozofik. Pas

20 vitesh u ula sërish në banka. Këtë herë në të parën si student i arsimimit parashkollor. I thashë vetes se do të bëja gjithçka që kisha në dorë që, nëse do të largohesha, të mos pendohesha që nuk isha përpjekur të studioja. Nota ime e parë në studimet e mia ishte dhjetë nga Sociologjia, e cila më inkurajoi dhe më dha një të shtyrë. U tremba sërish si në shkollë të mesme. Në mëngjes shkoja në leksione, pasdite pastroja rrugët dhe në mbrëmje studioja. Edhe pas mundimit tim të madh, arrita të mbaroj studimet universitare, me mesatare nëntë dhe u diplomova me notën dhjetë. Me të njëjtat nota kam mbaruar studimet pasuniversitare. Pas studimeve pasuniversitare më është dashur të largohem nga Ndërmarrja Komunale për të bërë praktikë në kopshtin “Sunce” në Nikshiq. Ishte hera e parë që një burrë punonte si edukator dhe më pas një rom. Kisha frikë se si do të më pranojnë kolegët dhe prindërit, se a do të më linin të punoja me fëmijët. Gjithçka shkoi mirë, fëmijët më donin dhe unë ndaja me ta momentet më të mira të jetës sime, ndërkohë që u kushtoja vëmendje, i mësoja, i edukoja ose kur luanim bashkë në shfaqjet e mia teatrale për fëmijë. Nga një fëmijë fitova dhuratë një libër ku shkruhej: Për mësuesin tim më të mirë. Isha i emocionuar shumë. Kështu që unë theva paragjykimet dhe stereotipet për romët dhe ndërtova ura miqësie. Por kur mbarova praktikën, humba sërish punën dhe fillova të jetoj sërish me asistencë sociale. Ish-kolegët e Ndërmarrjes Komunale më thanë se do të duhej të qëndroja me ta. Një ditë fëmijët më pyetën: Babi, a ia vlen të shkollohesh? Ti përsëri je pa asgjë. Vendosa t’i shkruaj një letër Qeverisë për të më ndihmuar. Kryeministri i atëhershëm, z. Millo Gjukanoviq, më ftoi për intervistë dhe përmes këshilltarëve të tij më ofroi një ndihmë financiare dhe punësimin në Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave, për çka i jam jashtëzakonisht mirënjohës gjatë gjithë jetës sime. Që atëherë jam punësuar në Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave. Ndërkohë në vitin 2015 janë hapur studimet master në drejtimin parashkollor. Eprorëve të mi u thashë se do të doja të regjistrohesha në master dhe ata më mbështetën në këtë. Mbarova në kohë studimet master dhe u diplomova sërish me notën dhjetë. Tema e punimit tim të magjistraturës ishte: “Qasjet antidiskriminuese në arsimimin parashkollor të Malit të Zi”. Ndërkohë vajza ime mbaroi studimet universitare në të njëjtën fushë si unë dhe djali im mbaroi shkollën e mesme. Sot fëmijët e mi jetojnë në Gjermani. Ajo punon si edukatore, ndërsa djali i saj u diplomua në Fakultetin e Elektro-inxhinierisë dhe të dy krijuan familjet e tyre. Megjithatë, përpjekja ime dhe arsimimi im dhanë rezultat. Sot mund të jem i kënaqur me punën që bëj dhe mund të jem i barabartë me kolegët e tjerë dhe të ndihmoj bashkatdhetarët e mi që të përmirësojnë pozitën e tyre në shoqërinë malazeze. Unë dua të bëj sa më shumë gjëra të dobishme për shoqërinë dhe bashkatdhetarët e mi. Nëpërmjet shembujve dhe praktikës së mirë, dua të inkurajoj sa më shumë romë që të shkojnë në shkollë, në mënyrë që një ditë të jetë normale që romët të arsimohen dhe të mbarojnë fakultetin. Do të përpiqem, me aq sa mundem, të jap kontributin tim për daljen e popullatës rome nga varfëria dhe zakonet e këqija të jetës, në mënyrë që secili prej tyre të thotë me krenari - unë jam rom, të gjithë jemi njësoj dhe vlejme njësoj. Ndërkohë unë dhe gruaja ime u bëmë gjyshër, fituam mbesën e parë, gjegjësisht fëmijën e parë të djalit tonë.



Unë jam aktiviste rome-egjiptiane që nga viti 2014 dhe jam e angazhuar për të përmirësuar pozitën e komunitetit tim. Aktualisht jam e punësuar në Shkollën fillore “Milleva Lllajoviq Lallatoviq” si bashkëpunëtore në përfshirjen sociale të romëve dhe egjiptianëve në fushën e arsimit. Së shpejti do të filloj të punoj si fasilitatore në komunën e Nikshiqit përmes programit ROMACTED të cilin e zbaton Këshilli i Evropës në bashkëpunim me OJQ-në “Romët e Rinj”. Kam lindur në Tivar, ku kam mbaruar shkollën fillore dhe të mesme. Shkollën fillore e kam nisur pa e ditur gjuhën zyrtare, ndaj prindërit e mi kanë menduar të më përjashtojnë nga shkolla. Megjithatë, shpejt e përvetësova gjuhën dhe mësimet, kështu që fillova të ndihmoja miqtë e mi nga komuniteti shumicë në detyrat e shtëpisë. Pasi mbarova shkollën fillore me sukses të shkëlqyeshëm, u regjistrova në Gjmnazin “Niko Rollovqi” në Tivar.

Më pas, në moshën 15-16 vjeçare, prindërit e mi filluan të merrnin disa oferta për të më martuar dhe për të më “siguruar”, por babai nuk e donte këtë. Ai donte që unë të arsimohesha dhe të martohesha kur të vinte koha. Pasi mbarova me sukses shkollën e mesme, u regjistrova në Fakultetin e Nikshiqit në drejtimin Pedagogji. Kushëriri im Përparim Isufaj më lidhi me Andrija Gjukanoviq, i cili punonte në Fondin për Rom dhe i cili më njohu me të drejtat e mia si pjesëtare e komunitetit rom dhe egjiptian. Në universitet takova Fana Dellijën dhe punën e saj, dhe në atë kohë fillova të njihesha me aktivitetin shoqëror.

Me bashkëshortin tim u njoha në vitin 2016 dhe u bëra prind në vitin 2019. Tani jam një nënë e kompletuar e dy fëmijëve, që kam arritur të ndërtoj një karrierë dhe po përpiqem të vendos një ekuilibër mes familjes dhe karrierës.

Vajza ime tre vjeçare është e regjistruar në kopsht dhe e di gjuhën zyrtare më mirë se unë kur isha në moshën shtatë vjeçare, kur fillova shkollën fillore.

I lus bashkatdhetarët e mi, të cilët janë realizuar në rolin e prindërve, të shfrytëzojnë mundësinë që arsimiti parashkollor është falas dhe u bëj thirrje që të paktën një vit t'i dërgojnë fëmijët në institucionet parashkollore. Është shumë e rëndësishme që ata ta njohin gjuhën zyrtare, që të mos mbeten prapa në klasën e parë të shkollës fillore dhe të humbasin vullnetin për ta ndjekur atë, sepse arsimiti është çelësi për përmirësimin e pozitës së komu-

nitetit tonë në shoqëri. Prindër, jini përkrahës të fëmijëve tuaj gjatë shkollimit, ashtu siç ishin prindërit e mi për mua. Kush e di, ndoshta një ditë fëmija juaj do të përfundojë fakultetin dhe do të jetë shembull për të rinjtë nga komuniteti ynë.



Elvis Berisha

Drejtor ekzekutiv i organizatës rinore romë
“Ecni në hap me ne - Phiren Amenca”

Unë quhem Elvis Berisha dhe kam përfunduar studimet universitare në drejtimin e Sigurisë dhe Kriminologjisë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Malit të Zi, ku u specializova për Ballafaqimin Kriminolistik me Format Moderne të Kriminologjisë në Fakultetin Juridik. Unë jam themelues dhe drejtor ekzekutiv i organizatës rinore romë “Ecni në hap me ne - Phiren Amenca” që nga viti 2014. Themelues dhe drejtor i portalit të parë rom RomaNet.

Përveç kësaj, jam një aktivist rinor dhe gazetar. Studiuës i shkëlqejve të të drejtave të njeriut të komunitetit rom dhe aktivist për pozitën e barabartë të komunitetit rom.

Jam i përfshirë në aktivitetet dhe forcimin e aktiviteteve mes anëtarëve të tjerë të komunitetit rom. Unë drejtoj një organizatë që e kam formuar me studentë të rinj nga komuniteti rom në vitin 2014 dhe redaktoj portalin RomaNet.

Jam rritur në një familje të varfër në të cilën kam qenë fëmija më i vogël në familje deri në moshën 11 vjeçare. Deri në vitin e katërt kam jetuar me familjen time në Danillovgrad, kur u dëbuam nga ai vendbanim me familje të tjera romë për shkak të ngjarjes fatkeqe që ndodhi. Duket se që atëherë, në moshën katër vjeçare, kam jetuar me diskriminimin dhe refuzimin nga shoqëria në tërësi. Krahas problemeve të përditshme me ushqimin dhe nevojat e tjera elementare, prindërit e mi prej kohësh përballen me problemin e shqetësimit nga pronarët e objekteve të cilëve u paguanim qiranë e banesës. Çdo pesë deri në dhjetë muaj ne do të ishim në rrugë pa asnjë ide se ku të shkonim më pas. Ne nuk kishim çati mbi kokë, shpesh kërkonim strehim tek të afërmit e nënës. Babai im merrej me punë të ndryshme fizike, ngarkonte dhe shkarkonte kamionë me fruta, shiste shishe vere prej qelqi dhe arrinte sadopak të zbukuronte fëmijërinë tonë dhe të na siguronte vakte të rregullta. Prindërit na bënë gjithmonë të shkonim në shkollë. Megjithatë, unë nuk shkova në kopsht sepse prindërit e mi ishin të zënë me punë duke u përpjekur të siguronin para të mjaftueshme për qira dhe gjëra të tjera të nevojshme. Nuk patën mundësi të më paguanin kopshtin dhe të më çonin e kthenin çdo ditë nga kopshti. Prandaj, në fund, motra ime, e cila ishte fëmija më i madh, nuk ia doli të arsimohej. Ajo duhej të linte shkollën për t'u kujdesur për mua, ndërsa prindërit e mi punonin gjithë ditën. U rrita shpejt, fillova të ndjek shkollën fillore. U bëra më i vetëdijshëm se

duhej të arsimohesha, por shpesh ndjeja një ngërç në stomak teksa i afrohesha shkollës. Në atë kohë kisha pak njohuri për gjuhën serbe dhe për këtë arsye shpeshherë vija në situata ku nuk më pëlqente shumë shkolla. Unë heshtja në klasë, por përpiqesha të dëgjoja dhe të mësoja diçka të re. Isha i vetmi rom në klasë dhe kjo më bëri që në moshë të vogël të luftoja për vendin tim në shoqëri. Nuk e di sa kam qenë i suksesshëm në këtë, por fakti që nuk jam diskriminuar asnjëherë nga fëmijët e tjerë të klasës, tregon se ja kam dalë, edhe pse kam ndenjur në bankën e fundit të klasës deri në klasën e pestë.

